



FLR.0050

FLOOR LEVEL

Llaç autonivelues të shpejtë për nivelime të sheshta të nënshtresave

Kodi doganor

3824 5090

Amballazhimi

- Qese 25 kg
- Koli: 50 x (Qese 25 kg)

Aplikimi

- Shpatull
- Shpatull e dhëmbëzuar
- Staggia

Familja
Floortech

Tipologjia
Llaçe çimentoje vetë-niveluese (nivelues)

Linjat e produkteve
• Building
• Floor

Kategoritë e përdorimit
• Realizimi i skeletit të themeleve, të shtresave të themeleve, niveleve dhe fibrave përforcuese

Përbërësit
Monokomponent

Paraqitja
Pluhur

Certifikimi dhe rregulloret



EN 13813

Screed material and floor screeds - Screed material - Properties and requirements



C30 F7

EN 13813

Përshkrimi i produktit

FLOOR LEVEL është një autonivelant me bazë çimento, polimer i modifikuar, i përforcuar me fibra, për shtrim të përshpejtuar dhe ngurtësim të shpejtë, që përdoret për rregullime nivelimi përpara shtrimit të dyshemeve, me trashësi nga 3 mm deri në 15 mm, duke e bërë të përshtatshme për të pranuar çdo lloj shtrimi pllakash.

Të dhëna shtesë

Karakteristikat e derdhshmërisë së përsosur, rrjedhshmërisë, dhe autonivelimit të këtij produkti lehtësojnë procesin e përhapjes së tij duke lejuar arritjen e një nivelimi të shpejtë dhe të përsosur. Duke derdhur produktin mbi mbajtësen dhe duke ndihmuar përhapjen e autonivelantit me shpatull, sipërfaqja e përfutur është krejtësisht e lëmuar, falë edhe imtësisë së lartë të përbërësit të silikatit (përmasa maksimale 0,5 mm). FLOOR LEVEL përmban reduktues-kompensues tkurrjeje, të përforcuar me fibra mikrofijesh speciale xhami antiplasaritëse, rezistente ndaj alkalineve, dhe me përmbajtje të lartë zirkoni (teknologjia READYMESH), e gjitha kjo për t'i dhënë qëndrueshmëri të jashtëzakonshme produktit. Në rastin e streseve veçanërisht të forta statike ose dinamike, versioni FLOOR LEVEL SFR është i disponueshëm, i përmirësuar me shtimin e mikrofibrave metalikë READYMESH MR-060. FLOOR LEVEL ka në përbërje një ngjitës pluhur special që i jep produktit aftësi ngjitëse mbi mbajtëse të ndryshme pa ndikuar në karakteristikat autoniveluese dhe përshkueshmërinë ndaj avujve të ujit. Zhvillimi i shpejtë i rezistencës mekanike lejon përparimin e shpejtë të punimeve në kantier dhe shkeljen mbi sipërfaqe vetëm pak orë pas shtrimit (rreth 4-5 orë në 20°C). Tharja e shpejtë lejon përshpejtimin e proceseve të shtrimit dhe finiturës së dyshemesë (kontrolloni gjithmonë përmbajtjen e lagështisë së përbërjes së tharë me igrometër me karbur kalciumi ose igrometër elektrik, duke pasur gjithnjë parasysh që ky i fundit siguron vlera thjesht treguese që duhen kalibruar paraprakisht mbi produkt).

Konsumi

Përafërsisht 1,8 kg/m² FLOOR LEVEL për çdo milimetër të trashësisë që duhet të bëhet.

Fushat e përdorimit

FLOOR LEVEL përdoret për nivelime të sheshta të nënshtresave të rregullta që do të shtrohen më pas me dysheme të tipeve të ndryshme (qeramike, mermer, druru, materiale plastike etj.) në mënyrë të vecantë në ato raste ku kërkohet shpejtësi ekzekutimi dhe një rezistencë e lartë ndaj ngarkesave dhe ndaj lëvizjeve mbi dyshemenë e përfunduar. Disa shembuj nënshtresave: • pllaka betoni dhe mallë çimentoje; • nënshtresa anhidrite; • dysheme me ngrohje; • dysheme ekzistuese prej betoni, pllaka, gurë natyrorë, magnezit; • dysheme ekzistuese prej qeramike para mbushjes me rrëshirë dypërbërëse SYNTECH RGS (rreth 1.2kg/m²) dhe derdhja e FLOOR LEVEL mbi rrëshirë akoma të njomë. Versioni FLOOR LEVEL SFR, i përmirësuar me shtimin e mikrofibrave metalikë READYMESH MR-060, është i disponueshëm për zonat veçanërisht të stresuara të aplikimit, siç janë shtrojat që i nënshtrohen streseve intensive dinamike-vibruese, të cilat përmirësojnë funksionet antikrruese dhe rrisin rezistencën dhe forca elastike e llaç autonivelues.



www.azichem.com

Përditësimi më: **27/09/2021**
Kushtet e shitjes dhe parashikimet ligjore mund të lexohen në www.azichem.it/disclaimer

Vetitë kryesore



I pandezshëm



Jetëgjatësia:
6 muaj



Përmasa maksimale e agregatit:
0.5 mm



Përzierja me ujë:
19 %



Pot life:
20 min



Rezistent ndaj rrezeve UV



Temperatura e aplikimit:
+5 / +30 °C



Trashësia maksimale e lejueshme:
15 mm



Trashësia minimale e lejueshme:
3 mm



Ngjyrat në dispozicion
Gri

Veçoritë teknike

Koha e hedhjes: 40-60 min

Lidhja e aderimit (EN 1015-12): > 2 MPa

Masa vëllimore (UNI EN 1015-6): 2050 kg/m³

Moduli elastik (EN 13142): 18000 MPa

Përmbajtja e klururit (UNI EN 1015-17): < 0.01 %

Përshkueshmëria e avullit të ujit μ: 40 _

Përthitha kapilare (UNI EN 13057): 0.35 kg/(m² • h^{0.5})

pH: > 12 _

Rezistenca në ngjeshje pas 01 dite (EN 12190) : > 4 MPa

Rezistenca në ngjeshje pas 28 ditësh (EN 12190) : > 38 MPa

Rezistenca në përkulje pas 01 ditë (EN 196): > 2 MPa

Rezistenca në përkulje pas 28 ditësh (EN 196): > 8 MPa

Mjetet e pastrimit

- Ujë

Shtresat e lejuara

- Beton
- Tulla dhe pllaka
- Nënshtrësia çimentoje
- Tulla
- Gurë natyrorë

Përgatitja e shtresave (mbështetëse)

Sipërfaqet e aplikimit duhet të jenë të pastra nga pluhurat, pa papastërti, bojëra, copëza të thërrmuara e të papërshtatshme etj. Përdorni metoda të frytshme mekanike për heqjen e mbetjeve që mund të ndikojnë në ngjitjen e produktit. Mbi mbajtëset normalisht përthithëse këshillohet një larje e lehtë e sipërfaqeve me ujë për të pastruar sipërfaqen dhe për të favorizuar ngjitjen e FLOOR LEVEL. Kur mbajtësja rezulton veçanërisht përthithëse ose e dobët/e shkrifët, ose kur nuk është e mundur të realizohet procesi i larjes së lehtë, është e këshillueshme të lyhet sipërfaqja me BOND PLUS, një rrëshirë speciale në tretësirë ujore, duke e përhapur mundësisht rrëshirën me anë të një furçe me fije të forta për të favorizuar depërtimin e saj në mbajtëse. Në të gjitha rastet në të cilat sipërfaqet janë të lyera me BONDPLUS, shtrimi i FLOOR LEVEL duhet të bëhet "i njomë mbi të njomë" pra menjëherë pas lyerjes me BOND PLUS (ne sasi rreth 200gr/m²). Mbi mbajtëset jothithëse, si ato prej xhami ose qeramike, si për shembull pllaka prej materiali qeramike ose klinker, sipërfaqet duhen lyer paraprakisht me rrëshirën dypërbërëse SYNTECH RGS (në sasi 1,2kg/m²), dhe FLOOR LEVEL duhet të përhapet mbi rrëshirë akoma të patharë.

FLOOR LEVEL mund të pompohet, por duke qenë një produkt për shtrim të përshpejtuar, derdhja duhet të jetë e vazhdueshme dhe pa ndërprerje (zbrazni plotësisht të gjithë qarkun e pompimit nëse vihen re ndalesa në pompim më të gjata se 10 minuta).



www.azichem.com

Përditësimi më: **27/09/2021**
Kushtet e shitjes dhe parashikimet
ligjore mund të lexohen në
www.azichem.it/disclaimer

Mënyra e përdorimit

Përziejini me një turiele me helikë të trefishtë me numër të lartë rrotullimesh ose me një përzierës me bosht vertikal. Vendosni në përzierës 2/3 e ujit total të të gjithë masës së përfutuar, duke shtuar gradualisht produktin dhe ujin e mbetur, dhe duke e përzier për rreth 2-3 minuta derisa të arrihet një masë homogjene me konsistencë të derdhshme. Uji i përdorur duhet të përbëjë nga 18% deri në 20% të masës së gjithë përzierjes (nga 4,5 deri në 5 litra për çdo thes 25kg). Derdheni masën e përfutuar mbi mbajtësen dhe përhapeni me një shpërndarës të gomuar, shpatull standarde mekanike ose shpatull të dhëmbëzuar (e prirur për të arritur përhapjen e dëshiruar). Falë karakteristikave të tij të përsosura të autonivelimit FLOOR LEVEL mbyll menjëherë brazdat e shpatullës së dhëmbëzuar dhe rregullon papërsosmëritë e vogla të shkaktuara nga levizja e shpatullës (rrjedhje të nivelimit me shpatull). Përfundojini veprimet e rregullimit dhe lëmimit brenda 20 minutave. Produkti ka tharje dhe ngurtësim të përsheptuar dhe nuk lejon të bëhen pushime gjatë përzierjes dhe përhapjes së tij. Tharja e produktit ndodh për rreth 45 minuta dhe ai bëhet i shkëlqem pas pak orësh.

Magazini e Ruajtja

Ruajeni produktin në ambalazhimin origjinal, në një mjedis të freskët dhe të thatë, duke shmangur acarin dhe rrezet e drejtpërdrejta të diellit. Ruajtja e papërshtatshme e produktit mund të shkaktojë humbje të vetive reologjike. Mbrojeni nga lagështia.



Paralajmërimë, Masa paraprake, Ekologji

Të dhënat e përgjithshme, ashtu si dhe indikacionet dhe sugjerimet për përdorimin e këtij produkti, të paraqitura në këtë fletë teknike të të dhënave dhe mundësisht të shpjeguara dhe me gojë ose me shkrim, përputhen me gjendjen aktuale të njohurive tona shkencore dhe praktike.

Të dhënat teknike dhe të performancës të paraqitura janë rezultat i provave laboratorike të kryera në një mjedis të kontrolluar dhe si të tilla mund të ndryshojnë në lidhje me kushtet e vënies në funksionim.

Azichem Srl nuk merr asnjë përgjegjësi që rrjedhin nga performanca jo e duhur që ka lidhje me përdorimin jashtë rregullave të produktit, ose që ka lidhje me defektet që rrjedhin nga faktorë ose elementë që nuk kanë lidhje me cilësinë e produktit, duke përfshirë këtu dhe konservimin e pasaktë.

Kushdo që synon të përdorë produktin duhet të vendosë, para përdorimit, nëse është i përshtatshëm për përdorimin e synuar, duke marrë përsipër të gjithë përgjegjësinë e tij.

Karakteristikat teknike dhe të performancës të përfshira në këtë fletë të dhënash teknike përditësohen në mënyrë periodike. Për një konsultë në kohë reale lidhuni me sitin: www.azichem.com. Data e rishikimit paraqitet në cep të produktit. Ky njoftim anulon dhe zëvendëson çdo njoftim tjetër të mëparshëm.

Mos harroni se përdoruesi është i detyruar të lexojë Fletën më të fundit të të Dhënave të Sigurisë së këtij produkti, që përmban të dhëna kimike-fizike dhe toksikologjike, parashikimet e rrezikut dhe informacione të tjera me qëllim që të transportojë, përdorë dhe asgjësojë produktin dhe paketimin e tij me siguri të plotë. Për konsultim lidhuni me sitin: www.azichem.com.

Ndalohet hedhja e produktit dhe / ose ambalazhit të tij në mjedis.



www.azichem.com

Përditësimi më: 27/09/2021
Kushtet e shitjes dhe parashikimet
ligjore mund të lexohen në
www.azichem.it/disclaimer



Via Giovanni Gentile, 16/A - 46044 Goito (MN), Itali
info@azichem.com Tel. +39 0376.604185 /604365 Fax +39 0376 604398



www.azichem.com

Përditësimi më: **27/09/2021**
Kushtet e shitjes dhe parashikimet
ligjore mund të lexohen në
www.azichem.it/disclaimer